

VENDIM
Nr. 195, datë 12.12.2019

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN NËNTOR 2019

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 114/10 prot., datë 5.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, për muajin nëntor 2019,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a, me shkresën nr. 23902 prot., datë 25.11.2019, paraqiti në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin nëntor 2019.

- Nëpërmjet këtij aplikimi, OSHEE sh.a. ka llogaritur që çmimi i shitjes së energjisë elektrike të klientët e FMF-së, për muajin nëntor 2019, të jetë 14.68 lekë/kWh.

- Llogaritjet e OSHEE sh.a., si dhe propozimi i ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF, për muajin nëntor 2019, sipas: “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Nëntor 2019				
Nëntor 2019		Aplikimi OSHEE Sh.a	Propozimi i ERE	
		Njësia	Çmimi	Çmimi
a	Çmimi maksimal i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	10.330	10.330
b	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.31	0.31
c	Çmimi maksimal i blerjes në periudhën relevante	Leke/kWh	10.64	10.64
d	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
e	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
f	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë (c+d+e+f)		Leke/kWh	14.68	14.68

OSHEE sh.a., për muajin shtator 2019, ka zhvilluar vetëm një procedurë për blerjen e energjisë nga tregu i parregulluar, ku çmimi maksimal i blerjes së energjisë elektrike prej 83.80 euro/mwh, i përket energjisë elektrike të blerë nga shoqëria EFT AG sh.p.k., loti 1, realizuar në datën 28.10.2019, për sasinë totale prej 58,080 mwh, me një vlerë prej 4.867,104 euro ose 600,211,265 lekë.

- Informacioni i detajuar mbi realizimin e procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga tregu i parregulluar, është marrë në platformën online: <http://oshee.al/kalendari-i-ofertave/>, të OSHEE sh.a.

- Në aplikimin për çmimin FMF, për muajin nëntor 2019, OSHEE sh.a. ka zbatuar me korrektësi përcaktimet e nenit 8, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018, të bordit të ERE-s” për sa i përket çmimit maksimal të blerjes.

- Gjendur në kushtet e pamundësisë së ndarjes së kostove të FMF nga ato të FSHU, për përcaktimin e kostove administrative (elementi CA i formulës), pranohet kosto për njësi prej 1.79 lekë/kWh, të paraqitur nga OSHEE sh.a.

- Shoqëria OSHEE sh.a, nuk informon mbi evidentimin e kostove të disbalancave për klientët e FMF dhe nuk deklaron nëse i faturon këta klientë për këto kosto në zbatim të pikës 5, të nenit 6, të metodologjisë përkatëse.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, bazuar në vendimin nr. 266, datë 21.12.2018, të bordit të ERE-s: “Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria ‘OST’ sh.a. për vitin 2019”, është 0.75 lekë/kWh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, bazuar në vendimin nr. 268, datë 21.12.2018, të bordit të ERE-s: “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 190, datë 30.8.2018, në lidhje me tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal, për vitin 2019”, është 1.5 lekë/kWh.

- Për sa përcaktuar, për çdo element të formulës përlllogaritëse, rezulton që çmimi i shitjes nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin nëntor 2019, të jetë 14.68 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të furnizimit me energji elektrike, nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, prej 14.68 lekë/kWh, për muajin nëntor 2019.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti